

VENDIM
Nr.52, datë 9.5.2008

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.46, DATË 10.8.2007 “PËR PËRCAKTIMIN E
VLERËS SË GJOBAVE DHE LLOGARITJES SË DËMIT, QË DO TË APLIKOHEN
NDAJ KLIENTËVE ME KUNDËRVAJTJE NË PËRDORIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 46/1, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.38, datë 21.3.2008 “Për fillimin e procedurave për një shtesë në vendimin nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit, që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike””, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.5.2008, pasi diskutoi mbi mënyrën e llogaritjes së dëmit të shkaktuar nga konsumatorët në kundërvajtje të përdorimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.46, datë 10.8.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit që do të aplikohet ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike” pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen:

3. Për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë në kundërvajtje të përdorimit të energjisë elektrike, në rastet kur çmimi i shitjes së energjisë elektrike është i ndryshëm në varësi të sasisë së konsumit apo të kohës së konsumit, sasia e kwh-së së faturuar si dëm të llogaritet bazuar në çmimin maksimal të shitjes së energjisë elektrike në përputhje me kategorinë e konsumatorit.

2. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojnë KESH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta